



KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe 17 shkronja h) të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, nenit 5 shkronja d) të Ligjit nr.03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, Rregullores (QRK) nr:19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar (me theks neni 14 paragrafi 8.1), neneve 14, 15 paragrafi 2.4 dhe neni 19 paragrafi 1.8 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, dhe në Kërkesë/Propozim nr.prot.01-020/04-0002552/26 datë 13.01.2026 të Drejtorisë së Arsimit, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 29 janar 2026, miratoi këtë,

V E N D I M

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËR PËRZGJEDHJEN E DREJTORËVE/SHAVE DHE ZËVENDËSDREJTORËVE/SHAVE NË INSTITUCIONET PUBLIKE EDUKATIVO ARSIMORE TË KOMUNËS SË PODUJEVËS

Neni 1

Me këtë vendim formohet Komisioni për përzgjedhjen e drejtorëve/shave dhe zëvendësdrejtorëve/shave në institucionet publike edukativo arsimore të Komunës së Podujevës, në përbërjen si vijon:

1. **Blerim Vllasa**, zyrtar për arsimin e mesëm të lartë në Drejtorinë e Arsimit, kryesues
2. **Bahrie Talla**, drejtoresh në SHFMU "Hyzriu e Samiu" në fshatin Letanc, anëtare
3. _____ Përfaqësues i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, anëtar/e, i/e cili/a caktohet nga kjo Ministri.

Neni 2

Komisioni punët dhe detyrat i kryen në pajtim me dispozitat e Ligjit nr.03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, Rregullores (QRK) nr:19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar, si dhe dispozitave tjera ligjore dhe nënligjore përkatëse që rregullojnë këtë fushë.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Drejtoria e Arsimit në Komunën e Podujevës.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform dispozitave të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, Ligjit nr.08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, si dhe Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren (QRK) nr.06/2021.

Nr.Prot. 01-020/04-0006428/26
Podujevë, datë; 29 janar 2026



Kryesuesi i Kuvendit
Isak Shabani